

INFORMATA RRETH SAVE THE CHILDREN

Organizata Save the Children vepron në Kosovë që nga viti 1997, me një zyrë kryesore në Prishtinë dhe prezencë gjeografike në 7 komuna (Pejë, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë të Jugut, Mitrovicë të Veriut, Ferizaj, Klinë, Junik dhe Gjilan). Me një qasje me spektër të gjerë të planifikimit programor, ne angazhohemi si në projekte afatgjata të zhvillimit ashtu edhe në intervenime emergjente në fushën e Mbrojtjes së Fëmijëve, të Qeverisjes për të Drejtat e Fëmijëve, Edukimit dhe Shëndetit dhe Ushqyerjes. Qasja jonë programore bazohet në ndërhyrje të drejtpërdrejta dhe në krijimin e praktikave të mira, ndërtimin e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe bartësve të detyrave lokale për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve. Ne avokojmë që legjislacioni dhe politikat të përfshijnë praktika gjithëpërfshirëse dhe të kenë mekanizma të duhur financiarë për të kryer reagime sistematike dhe kështu do të arrihen ndryshime pozitive për të gjithë fëmijët. Suksesi në Save the Children në Kosovë rrjedh nga partneriteti strategjik që ka me komunitetet, OShC-të dhe bartësit e detyrave në nivel lokal dhe shtetëror. Fëmijët si mbajtës të të drejtave marrin pjesë në mënyrë aktive në formësimin e zgjedhjeve tona strategjike, si dhe në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e punës sonë në terren.

REZULTATET E PRITURA

Nga projekti "Fuqizimi i ofrimit të shërbimeve sociale për grupet më të cenueshme në Kosovë, si përgjigje ndaj COVID-19" priten rezultatet e mëposhtme:

- **6000+** persona përfitojnë drejtpërdrejt nga shërbimet e financuara sociale;
- **45** OJQ do të mbështeten me nën-grante ku do të përfitojnë 6000+ anëtarë të familjeve nga grupet e cenuara.
- **150** ofruesë të shërbimeve sociale përfitojnë nga pesë module të mbështetjes teknike që do të ofrohen për OJQ-të.
- **200+** punonjës të sektorit publik forcojnë kapacitetet e tyre në ofrimin e shërbimeve sociale.
- **40** Qendra për Punë Sociale në 38 komuna përfitojnë nga modulet e mbështetjes teknike të përshtatura për forcim institucional.
- **5.000+** persona mësojnë rreth disponueshmërisë së shërbimeve sociale dhe rrjeteve të ofruesve të shërbimeve.
- **1000+** persona në nevojë kanë qasje në platformën e shërbimeve sociale në internet.



FUQIZIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE PËR GRUPET MË TË CENUESHME NË KOSOVË SI PËRGJIGJE NDAJ COVID-19



QËLLIMI I PROJEKTIT



Personat të cilët jetojnë në kushte dhe mjedise të rënda ekonomike kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme në kohë të krizave pandemike. Shërbimet sociale të menjëhershme, të qasshme dhe cilësore janë elementi thelbësor për ta lehtësuar presionin që ka sjellë kriza e madhe globale ditëve të sotme. Objektivi i përgjithshëm i projektit “Fuqizimi i ofrimit të shërbimeve sociale për grupet më të cenueshme në Kosovë, si përgjigje ndaj COVID-19” si pjesë e reagimit ndaj situatës me pandeminë COVID-19” është që të rritet disponueshmëria e shërbimeve sociale të cilat kanë cilësi të lartë dhe janë të qasshme përmes një mekanizmi të financimit të palëve të treta për OJQ-të të cilat janë ofruese të shërbimeve sociale në Kosovë për grupet më të cenuara siç janë personat me aftësi të kufizuara.

Projekti i propozuar do të ndërtohet mbi tre komponente kryesore:

- 1) Financimi i palëve të treta në formën e nën-granteve për të paktën 30 OJQ vendore që ofrojnë shërbime sociale,
- 2) Ofrimi i trajnimeve/ushtrimeve për ndërtimin e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve sociale me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë pas përfundimit të projektit, dhe
- 3) Një fushatë avokimi dhe vetëdijësimi për t’i mësuar njerëzit, veçanërisht ata në zonat rurale dhe të largëta, për rëndësinë e shërbimeve sociale dhe për ta informuar publikun e gjerë për disponueshmërinë e shërbimeve dhe mënyrën se si mund të përfitojnë prej këtyre shërbimeve.

PËRFITUESIT KRYESORË



Personat dhe familjet në nevojë



Vajzat, djemtë, gratë dhe burrat që jetojnë në situata të cenuara



Viktimat e dhunës ndaj grave,
dhunës në familje ose trafikimit



Fëmijët dhe të rriturit që jetojnë me aftësi të kufizuara



Hartuesit e politikave dhe vendimmarrësit



Ofruesit e shërbimeve sociale



Personat dhe familjet në nevojë